



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

TERMA REFERENCE

MIRËMBAJTJE E SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR

Tiranë 2024

PËRMBAJTJA	
1. PËRFITUESI / AUTORITETI KONTRAKTUES	3
2. QËLLIMI I SHËRBIMIT	3
3. OBJEKTI I SHËRBIMIT	3
4. AFATI I SHËRBIMIT	3
5. ÇFARË ËSHTË SISTEMI	3
5.1 Përshkrim i Përgjithshëm	3
5.2 Analiza e Proceseve të Punës	4
5.3 Moduli Financë- Kontabilitet:	6
5.4 Moduli i të ardhurave:	7
5.5 Moduli i Blerjes dhe Magazinës	7
5.6 Moduli i Kontratave	7
5.7 Moduli i Buxhetit	8
5.8 Moduli i Burimeve Njerëzore	9
5.9 Moduli i Konfigurimeve (Administrator)	11
5.10 Dizenjimi i sistemit	12
5.11 Data STORE (Baza e të dhënave)	14
5.12 Infrastruktura hardware	14
5.13 Komunikimi me sistemet e tjera	15
6.SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR SHËRBIMIN E MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT	15
6.1 Specifikimet Teknike të Mirëmbajtjes së Sistemit	15
7. PËRGJIGJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT	17
Shërbimet e Mirëmbajtjes	17
a) Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese	17
b) Shërbime Riparimi në vendndodhje	17
c) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore	17
d) Përgjigjia ndaj Alarmeve Madhore	17
e) Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit	17
Penalitetet për mos-arritje të nivelit të shërbimit	19
8. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT	19

1. PËRFITUESI / AUTORITETI KONTRAKTUES

Përfituesi: Bashkia Tiranë dhe Institucionet e Varësisë

Autoriteti Kontraktues: Bashkia Tiranë

2. QËLLIMI I SHËRBIMIT

Qëllimi kryesor i këtij shërbimi është sigurimi i mirëmbajtjes së sistemeve:

- Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës
- Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë

duke mundësuar vazhdueshmërinë e funksionaliteteve dhe disponueshmëri të shërbimeve pa ndërprerje.

3. OBJEKTI I SHËRBIMIT

Objekti kryesor i këtij shërbimi është mirëmbajtja e sistemeve:

- Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës
- Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë.

me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës.

Mirëmbajtja parashikohet për një periudhë 1 vjeçare (12 muaj).

Sistemet janë të ndërtuar në formë modulare, secili modul ka funksionalitete të vecanta dhe janë pjesë e një platforme të vetme. Sistemet përdoren nga Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, dhe janë të integruar me njëri-tjetrin.

4. AFATI I SHËRBIMIT

Afati i shërbimit do të jetë për një periudhë 1 vjeçare (12 muaj) nga data e nënshkrimit të kontratës.

5. ÇFARË ËSHTË SISTEMI

5.1 Përshkrim i Përgjithshëm

Kjo kontratë synon realizimin e mirëmbajtjes së sistemeve ekzistuese në infrastrukturën e institucionit,

- Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës
- Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë.

në çdo komponent të tyre.

Me anë të sistemit ekzistues, është përfutur një databazë e unifikuar për të gjitha të dhënat e buxhetuara, realizimet dhe të dhënat operacionale përkatëse. Ky sistem është ndërtuar mbi bazën e një software të quajtur Odoo (Odoo 11, instaluar në Ubuntu Server 16.04.2 LTS), i cili në vetvete është krijuar me gjuhën e programimit Python.

5.2 Analiza e Proceseve të Punës

Në vijim përshkruhen gjerësisht proceset e punës dhe funksionet e detajuara për secilin prej sistemeve financiare.

Sistemet janë të bazuara në web. Ato mundësojnë përditësimin e informacionit në mënyrë të unifikuar nga të gjitha drejtoritë, Njësitë Administrative, apo dhe Institucionet e Varësisë pjesë e sistemeve respektive. Sistemet mundësojnë monitorim të kujdesshëm të të gjitha aktiviteteve të menaxhimit financiar dhe menaxhojnë cdo proces lidhur me to, për të siguruar arritjen e objektivave të Bashkisë Tiranë dhe të Institucioneve të Varësisë së saj.

- Sistemi “Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës”, përdoret nga përdorues të Bashkisë Tiranë:
 1. Drejtoria e Financës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, përdorues me të drejta sipas detyrave funksionale;
 2. Drejtoria e Buxhetit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, me përdorues me të drejta për të kryer veprime sipas detyrave funksionale;
 3. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar me nivel përdoruesi, sipas detyrave funksionale në drejtori;
 4. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, përdorues me të drejta për të kryer veprimet e magazinës;
 5. Drejtoria e Trajnim Zhvillimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me përdorues me të drejtra sipas detyrave funksionale në drejtori;
 6. Drejtoria e Përgjithshme e Qeverisjes Elektronike dhe Inovacionit, me të drejta administratori teknik (në nivel konfigurimesh dhe administrim të përdoruesve);
 7. Të gjithë strukturat e Bashkisë Tiranë, drejtoritë dhe njësitë administrative të saj, me përdorues me të drejta në modulin e burimeve njerëzore për të realizuar kërkesë për leje (raport, leje-barrelindje, mësimdhënie etj) aprovim dhe miratim përkatës, krijim/gjenerim/printim listeprezenca të stafit të strukturave përkatëse sipas organizimit administrativ në institucion (organigramës);
- Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë;

Përdorues në nivel Institucioni Varësie :

1. Në nivel përdoruesi apo specialisti me të drejta të përcaktuara. Çdo institucion është regjistruar sipas kodit përkatës dhe instancës përkatëse loguese:
 - Tirana Parking- TP
 - Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve- QEZHEF
 - Drejtoria e Përgjithme e Taksave dhe Tarifave vendore- DPTTV
 - Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit- APR

- Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit- AMK
- Agjencia e Shërbimeve Funerale-ASHF
- Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme- DKSHM
- Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit- DPN_1
- Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit Publik- DPN_2
- Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike- DPN_3
- Klubi Sportiv Tirana- KS_Tirana
- Qendra Kulturore Tirana- QK_Tirana
- Shkolla Luigj Gurakuqi- SH_Luigj_Gurakuqi
- Qendra Komunitare të Qëndrojmë së Bashku- QS_TQSB
- Qendra Sociale Multidisiplinare- QS_Multidisiplinare
- Qendra Komunitare "Shkozë"- QS_Komunitare
- Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët”- QS_Shtepia_Perbashket
- Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”- QS_GB
- Qendra Sociale “Strehëza”- QS_Streheza
- Agjencia e Administrimit të Tregjeve- AGJT
- Klubi Sportiv Studenti- KSS
- Klubi Shumësportësh Partizani- KSP
- Muzeu Vendor Kadare- MVK
- Qendra e Restaurimit të Veprave të Artit- QRVA
- Agjencia e Rinisë- AR
- Qendra Komunitare e Terrenit- QKT
- Muzeu Vendor ‘Shtëpia Studio Agolli’- MVSHSA
- Inspektoriat i Mbrojtje së Territorit- IMT
- Agjencia e Industrisë Kreative- AIK
- Galeria e Artit- GAT
- Qendra Ten- QR_TEN
- Qendra Komunitare “ Për persona me aftësi të kufizuara” –QPAK
- Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi- MZSH
- Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik- DPKZ

2. Drejtoria e Përgjithshme e Qeverisjes Elektronike dhe Inovacionit, me të drejta Administratori teknik (në nivel konfigurimesh dhe administrim të përdoruesve).

Të dy sistemet janë të ndërtuar në module, të cilët janë të integruara me njëri tjetrin. Sistemet janë konfiguruar si një paketë software e integruar që suporton shumë operacione dhe procese komplekse. Sistemi ofron hapjen e disa proceseve njëkohësisht dhe regjistrimin e të dhënave paralel dhe reflektimin në kohë reale.

Nëpërmjet sistemeve mundësohet:

- Forcimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në institucion.
- Harmonizimi i procedurave dhe proceseve si dhe ndërveprimi mes strukturave.
- Ndjekja e Buxhetit sipas programeve buxhetore të Bashkisë si një entitet i tërë dhe për institucionet e varësisë.
- Historiku kronologjik i çdo transaksioni, duke bërë të mundur një menaxhim të plotë të kontratave dhe angazhimeve të tjera.
- Ndjekja e proceseve, nga mbledhja e të ardhurave deri në arkëtimin e tyre.


- Ndjekja e proceseve, nga nënshkrimi i kontratave të ndryshme të furnizimit, blerje aktivesh, shërbimesh apo prokurime punimesh publike, deri në furnizimin faktik të tyre dhe kostove përkatëse.
- Konstatim dhe menaxhim sa më i saktë dhe në kohë i të drejtave dhe detyrimeve për shmangien e pasaktësive.
- Ngarkimi (upload) në sistem i dokumentacionit të nevojshëm, sipas proceseve të punës.
- Gjenerimi automatik i listëprezencës së punonjësve nëpërmjet integrit me sistemin e checkimit të kartave të aksesit në Bashkinë Tiranë.
- Marrja e raporteve të ndryshme që kërkohen me saktësi dhe në kohë.
- Monitorim të kujdesshëm të të gjitha aktiviteteve të menaxhimit financiar, menaxhim sa më të mirë në cdo proces lidhur me to, duke siguruar arritjen e objektivave madhore të Bashkisë Tiranë.

Sistemet përmbajnë modulet si më poshtë:

5.3 Moduli Financë- Kontabilitet:

Ky modul mundëson regjistrim të plotë dhe të saktë të të gjithave transaksioneve financiare, kontabilizim automatik dhe gjenerim të raporteve kontabël e financiar, konkretisht:

- Klientët
- Furnitorët
- Banka dhe arka
- Veprimet Kontabël
- Skemat (skemat e tatimtaksave)
- Rivlerësim i llogarive
- Procesim periodik (Rakordime, Veprime periodike, Mbyllja e periudhës)
- Aktivët (Aktivët, amortizimi i aseteve, hierarkia e aktivëve)
- Gjenerimin e raporteve sipas standardeve financiare si :
 - o Raporte blerje/ shitje,
 - o Raportet e Partnerëve,
 - o Raporte kontabiliteti,
 - o Raportet e aseteve,
 - o Raportet e pasqyrave financiare



5.4 Moduli i të ardhurave:

Në këtë modul regjistrohen:

- Planifikimi vjetor i të ardhurave.
- Planifikimi mujor i të ardhurave.
- Raportimi mujor i të ardhurave.
- Raporte standarte (parashikimi i të ardhura vjetore, realizimi i të ardhurave,)
- Konfigurime për muajt si dhe formate parashikimi të ardhurash.




5.5 Moduli i Blerjes dhe Magazinës

Ky modul përdoret nga specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe specialistët pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse (magazina).

Funksionalitetet kryesore të këtij moduli janë:

- Menaxhimi i magazinës (Fletë hyrje në magazinë, transferimet e produkteve, fletë dalje nga magazina).
- Lëvizja e produkteve
- Ndjekja e produkteve (Seri produktesh, ndjekja e inventarit).
- Kontrolli i inventarit (strukturat e vendndodhjeve)
- Regjistrimet e blerjes dhe statuset e tyre (konfigurimi i produkteve/ shërbimeve)
- Regjistrimet e hyrje/ daljes nga magazina
- Raportet e blerjes
- Raportet e magazinës



5.6 Moduli i Kontratave

Ky modul mundëson regjistrimin e kontratave të Bashkisë Tiranë, konfigurime mbi tipet e kontratave si dhe gjenerimin e raporteve mbi ecurinë e tyre.



5.7 Moduli i Buxhetit

Ky modul mundëson regjistrimin e buxhetit fillestar, amendimeve të buxhetit dhe gjenerim të raporteve të buxhetit. Modulet janë të ndara në Zbatimin e Buxhetit, Planifikimin e Buxhetit dhe Raportimin.

Zbatimi i Buxhetit përmban menutë:

- Plani i Miratuar
 - Plani i Miratuar
 - Detajim 602
 - Alokim Burimesh për investime
- Celja e Buxhetit
 - Kërkesa për celje
 - Kërkesa për celje për Investime
 - Avancim Fondi
 - Aprovimi i celjeve të Investimeve
- Ndryshim Buxheti
 - Ndryshim Buxheti
- Raporte Standarde
 - Celje Shpenzimesh
 - Celje Investimesh
 - Pasqyra Nr 3.1 (Zbatimi)
 - Evidenca Përmbledhëse
 - Evidenca Thesari
 - Evidenca Investimeve
 - Historik Ndryshime Buxheti
 - Rregjistri Analitik



Planifikimi i Buxhetit përmban:

- Plani i miratuar
 - Plan I miratuar
 - Alokim Burimesh për investime
- Tavanet
 - Tavanet
- Kërkesat Buxhetore

- Parashikimi i të Ardhurave
- Shpenzime Operative
- Kërkesa për Shpenzime Kapitale
- Kërkesa për Projekte 602
- Kërkesa të tjera Operative
- Kërkesa për Shpenzime Personeli
- Shpenzime të Huaja Investimi
- Konfigurimet
 - Artikujt
 - Projektet
 - Konfigurim PBA
 - Konfigurimi i të Ardhurave
 - Detajime
 - Konfigurimi i Strukturave Përgjegjëse
 - Donator
 - Kategori Investimi
- Ndryshimet e buxhetit
- Raportet Standarde
 - Tavanet
 - Raport Tavane
 - Tavane sipas Njësive
 - Tavane sipas programeve
 - Kërkesa Buxhetore
 - Kërkesa Përmbledhëse
 - Pasqyra Nr 3.1



Raportimi përmban:

- Detajim i shpenzimeve operative
- Realizimi i investimeve
- Evidenca e përdorimit të fondeve
- Evidenca e përdorimit të fondeve (e detajuar)




5.8 Moduli i Burimeve Njerëzore

Ky modul mundëson regjistrimin e kartelave të punonjësve, kontratave, listëpagesës mujore, gjenerim e raporteve të burimeve njerëzore si dhe sinkronizim me modulin e kontabilitetit.


Konkretisht ky modul përmban të dhëna mbi:

- Punonjësit (kartelat me informacionin personal, masat disiplinore nëse kanë si dhe kontrata e punës së çdo punonjësi).
- Pasqyrat e punës (ambienti ku janë të krijuara listë-presencat për secilën strukturë të Bashkisë Tiranë, dhe informacione mbi orët e punës për secilin punonjës (orarin kur ka check-uar në hyrje-dalje në sistemin e checkimit të kartave të aksesit).
- Lejet (ambient në të cilin janë të regjistruar lejet në varësi të llojit të tyre (leje vjetore, raport mjekësor, leje pa të drejtë page etj), të cilat kalojnë në satusë të ndryshme aprovimi sipas hierarkisë përkatëse (specialist- përgjegjës sektori- drejtor- drejtor i përgjithshëm- burime njerëzore), si dhe alokohen numër i caktuar ditësh leje vjetore në vit kalendarik.
- Lista e pagave - ambient në të cilin krijohen listë pagesat për punonjësit e Bashkisë Tiranë, si dhe ku mund të realizohet gjenerimi i pagave të stafit.
- Konfigurimet (ambient në të cilin realizohen konfigurime mbi punonjësit (kategoritë nëpunës civil, kontratë, periudhë prove etj) dhe pozicionet e punës së punonjësve (specialist, përgjegjës, drejtor, etj), gjithashtu realizohen konfigurime mbi kategoritë e departamenteve (sektor-drejtori- drejtor i përgjithshëm), bazuar në llojin e strukturës, konfigurime mbi llojet e lejeve, si dhe strukturat e pagesës (në bazë të kategorisë së pagës).

Në skemën më poshtë jepen të paraqitura funksionet bazë të proceseve për Modulin e BNj.



Në skemën më poshtë jepen të paraqitura funksionet bazë të proceseve për Modulin e BNj:



5.9 Moduli i Konfigurimeve (Administrator)

Në këtë modul mundësohen konfigurimet mbi:

- Email (severi i email hyrës; server i email dalës).
- Sekuenca e identifikuesit (kodet sekuenciale, identifikues të jashtëm).
- Planifikuesi- veprimet e planifikuara (alokim automatik i lejeve; përditësim i shtesës për vjetërsi pune, etj).
- Parametrat e konfigurimit.
- Integrimi- Webshërbimet e IMPRO (integrim me të gjitha instancat e Institucioneve të Varësisë së Bashkisë Tiranë).
- Integrimi me Sistemin e Vlerësimit të Performancës.
- Konfigurime mbi institucionin dhe struktura të tij.
- Përdoruesit- Të gjithë përdoruesit thirren nga AD e Bashkisë së Tiranës (integrimi LDAP) dhe cdo përdoruesi mund t'i jepen të drejta në bazë të rolit në sistem nga administratori.
- Siguria- përmban listat e kontrollit të aksesit si dhe rregullat e aksesit.
- Importi- për mundësi importimi të një konfigurimi ose dokumenti.


Bashkia Tirane (BASHKIA_TIRANE)				
Administrator				
Klientët Mbledhjet Produktet				
SHITJET BLERJET MAGAZINA KALENDAR PROJEKT KONFIGURIME BT KONTRATAT PLANIFIKIM BUXHETI ZBATIMI I BUXHETIT TE ARDHURAT RAPORTIMI KONTABILITETI BUREMET NJERZORE KONFIGURIME				
Modulet	Kërko: Përdoruesit			
Konfigurim	Emri i përdoruesit ? Hyrje ? Kompania			
Kompaninë	LDAP JO NGA LDAP			
Përdoruesit	Kërko Fshi			
Përdoruesit	Krijo Fshi			
Grupet				
Siguria				
Përshtat				
Përkthimet				
Garancitë				
Import				
Raportet				
EMRI I PËRDORUESIT	HYRJE	GRUPA	LEHJA E FUNDIT	
<input type="checkbox"/> Ada Qam	ada.qam	Albanian / Shoqë	12/01/2022 11:44:28	
<input type="checkbox"/> Ada Tocka	ada.tocka	Albanian / Shoqë	10/05/2021 10:44:20	
<input type="checkbox"/> Adelina Sulaj	adelina.sulaj	Albanian / Shoqë		
<input type="checkbox"/> Adhurim Basha	adhurim.basha	Albanian / Shoqë	07/12/2021 14:03:50	
<input type="checkbox"/> Administrator	admin	Albanian / Shoqë	16/05/2024 14:51:19	
<input type="checkbox"/> Administrator	administrator	Albanian / Shoqë	29/01/2018 14:11:19	
<input type="checkbox"/> Admir Dedei	admir.dedei	Albanian / Shoqë		
<input type="checkbox"/> Adrian Malollari	adrian.malollari	Albanian / Shoqë	23/07/2021 09:38:50	
<input type="checkbox"/> Adriola Agalliu	adriola.agalliu	Albanian / Shoqë		
<input type="checkbox"/> Aferdita Skura	aferdita.skura	Albanian / Shoqë	25/08/2021 13:15:52	
<input type="checkbox"/> Aferdita Skura	aferdita.skura	Albanian / Shoqë	25/08/2021 13:01:53	
<input type="checkbox"/> Agim Gapi	agim.gapi	Albanian / Shoqë	30/04/2019 11:41:26	
<input type="checkbox"/> Agim Maloku	agim.maloku	Albanian / Shoqë		
<input type="checkbox"/> Agnis Haseku	agnis.haseku	Albanian / Shoqë	09/04/2024 15:24:35	
<input type="checkbox"/> Aida Cela	aida.cela	Albanian / Shoqë	30/04/2019 11:41:26	
<input type="checkbox"/> Aida Cela	Aida.cela	Albanian / Shoqë	16/12/2019 09:04:44	
<input type="checkbox"/> Aida Laja	aida.laja	Albanian / Shoqë	07/12/2023 09:42:37	
<input type="checkbox"/> Akil Sokoli	akil.sokoli	Albanian / Shoqë	25/01/2024 15:40:19	
<input type="checkbox"/> Alara Sanli	alara.sanli	Albanian / Shoqë	04/04/2024 11:41:38	
<input type="checkbox"/> Alba Mahmuti	alba.mahmuti	Albanian / Shoqë	08/07/2021 15:03:39	
<input type="checkbox"/> Albana Sallaku	albana.sallaku	Albanian / Shoqë	30/04/2019 11:41:26	
<input type="checkbox"/> Alban Celaj	alban.celaj	Albanian / Shoqë		
<input type="checkbox"/> Alban Dushku	alban.dushku	Albanian / Shoqë		
<input type="checkbox"/> Alban Gjilani	alban.gjilani	Albanian / Shoqë	06/02/2024 11:29:27	
<input type="checkbox"/> Alba Tuci	alba.tuci	Albanian / Shoqë	03/10/2022 14:10:44	

Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë.


- Institucionet e Varësisë janë të konfigurueshme në sistem si njësi të vecanta.
- Konfigurimet e moduleve janë përshtatur duke përbushur kërkesat e institucioneve të varësisë dhe ato të Bashkisë për menaxhimin e tyre.
- Raportet në sistem japin informacion jo vetëm për Bashkinë e Tiranës por dhe për Institucionet e Varësisë dhe veprimet e aparatit.
- Sistemi lejon që regjistrimet të kenë disa statuse (draft, aprovuar, anuluar, etj). Për veprimet që kërkohet konfirmim nga Financa e Bashkisë, aprovimi i tyre lejohet vetëm nga përdorues të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
- Sistemi lejon që institucionet të kenë llogari kontabël, magazinë, produkte dhe çdo konfigurim të vecantë, njëra nga tjetra si dhe nga konfigurimet e Bashkisë. Konfigurimet përshtaten sipas njësive.
- Konfigurimet e QK, janë përshtatur sipas njësive vartëse dhe Raportet e qëndrave të kostos reflektojnë regjistrimet e të gjitha njësive.
- Sistemi lejon grupimin e punonjësve të vecantë sipas njësive vartëse dhe lejon filtrime/raporte të gjeneruara sipas njësive.
- Në të gjitha ndërfaqjet e sistemit, përdoruesit kanë mundësi filtrimi të veprimeve të regjistruara në çdo modul ose në çdo njësi. Mënyrat e filtrimit dhe grupimit të informacioneve mund të përshtaten nga përdoruesit.

5.10 Dizajnimi i sistemit

Komponentët e arkitekturës së sistemit paraqiten në figurën e mëposhtme:



STILET / MODELET për arkitekturën : Arkitektura MVC (Model-View-Controller)




5.11 Data STORE (Baza e të dhënave)

Shtresa e quajtur “Data Store” e cila është shtresa që merret me ruajtjen e të dhënave përbëhet nga Databaza PostgreSQL. PostgreSQL përmban të gjithë të dhënat e Application Layer dhe pothuajse të gjithë konfigurimet e IMPRO-s.

5.12 Infrastruktura hardware


Infrastruktura hostuese e sistemeve është e bazuar në teknologjinë VxRail nga EMC/VCE, një zgjidhje e konverguar që ofron virtualizim, procesim dhe hapësirë ruajtje të dhënash në një pajisje të vetme të shkallëzueshme, lehtësisht të menaxhueshme.



Pajisja VxRail 60 është e ndërtuar mbi procesor Intel Xeon x86, përbëhet nga 4 nyje në një njësi të vetme 2U. Ajo përfshin pajisjen hardware, VxRail Manager, EMC Secure Remote Services (ESRS) dhe akses në produkte të tjera EMC, së bashku me këta komponentë software:

- VCE VxRail Manager 3.5 build 3936871
- VMware vSphere 6.0 Update 2
- VMware vCenter Server Virtual Appliance (vCSA) 6.0 Update 2 GA ISO build 3634788
- VMware ESXi 6.0.0 Update 2 GA ISO build 3620759
- VMware Virtual SAN 6.2 GA ISO build 3620759

VMware vRealize Log Insight 3.3.1 build 3644329



5.13 Komunikimi me sistemet e tjera

Të dy sistemet:

Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës dhe

Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë, janë të integruara me AD e Bashkisë Tiranë.

Nëpërmjet intergrimit me mail serverin e Bashkisë Tiranë, sistemi mundëson një rrugë të dytë komunikimi midis hallkave të përfshira në proces.

“Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës”,

Është i integruar gjithashtu me:

- Sistemin e checkimit të kartave të aksesit (platforma Matrix)
- Sistemin e vlerësimit të performancës

Ky komunikim realizohet nëpërmjet webshërbimeve, të cilat suportojnë protokollet XML- RPC ose NET-RPC.

6. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR SHËRBIMIN E MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT

6.1 Specifikimet Teknike të Mirëmbajtjes së Sistemit

Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e sistemeve janë të shprehura në komponentët e mëposhtme:

1. Monitorimi periodik i rregullt i roleve dhe aktivitetit të përdoruesve të sistemit.
2. Kompania duhet të nxjerrë raporte pas monitorimeve periodike të cilat duhet të përfshijnë statusin e secilit komponent software pa përjashtuar edhe sugjerimet në adresë të infrastrukturës hardware.
3. Izolimi dhe diagnostifikimi e problemeve për çdo lloj problemi që afekton sistemin. Përgatitja e raportit dhe sugjerimet përkatëse për problemin.

4. Kompania duhet të garantojë suport në rast se një faktor i brendshëm apo i jashtëm afekton sistemin.
5. Rregullimi i çështjeve/incidenteve në të gjithë shtresat e sistemit.
6. Asistencë për raporte ose “queries” sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
7. Modifikimi dhe përmirësimi i funksionaliteteve sipas kërkesave të Autoritetit. Pavarësisht se kjo kontratë synon procesin e mirëmbajtjes së mirëmbajtje e sistemeve financiare të bashkisë tiranë dhe të institucioneve të varësisë, mund t’i lindë nevoja që herë pas here të kërkojë azhurnimin, përmirësimin apo modifikimin e sistemit duke u fokusuar por pa u kufizuar në:
 - Përmirësimi i performancës dhe funksionaliteteve të proceseve aktuale të sistemit
 - Modifikimi/përshtatja e funksionaliteteve të sistemit, referuar ndryshimeve ligjore përgjatë periudhës së mirëmbajtjes.
 - Përmirësimi i raporteve aktuale që gjenerohen nga sistemi sipas kërkesave të institucionit.
8. Të vijojë integrimi me Sistemin e Checkimit të Kartave të Aksesit, me LDAP dhe me Sistemin e Vlerësimit të Performancës, në menyrë që të automatizohen rolet e përdoruesve sipas hierarkisë, referuar ndryshimeve të cilat ka pësuar struktura e institucionit.
9. Transferimi i njohurive stafit IT dhe stafit përdorues të sistemit.
 - Trajnimi mbi funksionalitetet e sistemit
 - Trajnimi mbi konfigurimin dhe monitorimin e sistemit
 - Trajnimi mbi strukturën e databazës dhe source code të sistemit.
10. Ndërhyrjet në sistem duhet të propozohen me një akt plan të detajuar për t’u aprovuar. Kompania duhet të bëjë ndërhyrjet në kohën e përcaktuar.
11. Kompania duhet të ofrojë suport lokal 24x7 deri në përfundimin e kontratës së mirëmbajtjes.
12. Suporti i ofruar duhet të përfshijë kontrollet e detyrueshme parandaluese si dhe të përshkruajë dinamikat dhe furnizojë të gjitha detajet teknike mbi aktivitetet e planifikuara.
13. Kompania duhet të realizojë kontroll të detajuar i log-eve të sistemit.
14. Të ndryshme.

Kompania fituese duhet të krijojë / diskutojë me autoritetin kontraktor dhe një agjendë periodike kontrollesh parandaluese, por jo vetëm, si më poshtë:

1. Kontrolle Javore;
2. Kontrolle Mujore;
3. Etj.

7. PËRGJIGJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT

Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë:

a) Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese.

Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në muaj Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjithë komponentët e këtij projekti. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rikuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit. Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese do të kryhen pranë Bashkisë Tiranë, përveç rasteve kur në kontratë përcaktohet një vendndodhje e re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

b) Shërbime Riparimi në vendndodhje

Operatori ekonomik duhet të jetë i disponueshëm 24x7 për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar i Autoriteti Kontraktor (“Emergency On-Call Hours”). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarrë në rast të keqfunksionimit të komponentëve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëherëshme e të konsiderueshme të sistemit dhe që nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i Autoritetit Kontraktor dhe të rekomanduara nga operatori ekonomik. Problemet që nuk i përkasin “Alarmeve Madhore”, duhet të adresohen nën Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese.

c) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.

Stafi përgjegjes do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë Autoritetin Kontraktor dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 15 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar. Në momentin e njohjes së thirrjes nga operatori ekonomik, personeli i autorizuar do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar.

d) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore.

Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë nëpërmjet informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting shkakun e Alarmit Madhor, atëherë ai duhet të dërgojë një teknik shërbimi brenda intervalit kohor prej 1 (një) ore nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do ti jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

e) Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit.

Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa:

(a) Alarmi madhor të jetë korrektuar ose të jetë “zgjidhur në mënyrë të tërthortë”;

(b) Tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër;

(c) Operatori ekonomik të përcaktojë se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë

keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose;

(d) Operatori ekonomik arrin në konkluzionin që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

Operatori ekonomik duhet të dokumentojë cdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin e stafit përgjegjës për çdo ndërhyrje.

Operatori ekonomik do të realizojë një axhendë periodike kontrollesh si më poshtë:

1. Javore
 - Kontroll i log-eve të kryerjes se backup-eve
 - Kontroll i log-eve të aplikacionit
 - Mirëmbajtje proaktive.
2. Mujore.
 - Testim / kontroll i kompletuar i sistemit software
 - Kontroll i detajuar i gjithë log-eve software

Termet e Mirëmbajtjes:

- Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e mirëmbajtjes dhe shërbimeve të vazhdueshme (Marrëveshjen SLA) për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

Kategoria A (Kritik/ I Larte)	Kategoria B (I Mesem)	Kategoria C (I Ulet)
Mos funksionimi i aplikacionit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit pengon në mënyrë minimale aktivitetin
<i>Numri i përdoruesve të ndikuar</i>		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër <i>shumë të madh</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër <i>të vogël</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues
<i>Pezullimi i punës</i>		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</u>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesë te punës së tyre</u>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <u>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,</u>
<i>Zgjidhje alternative e përkohshme</i>		
<u>Nuk ka një mënyre alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	<u>Ka pjesërisht një mënyre alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<u>Ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
<i>Koha e përgjigjes</i>		
○ 10 min. për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 1 ore.	○ 30 min.për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 2 orëve	○ 60 min.për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 4 orëve
<i>Koha e zgjidhjes</i>		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

Penalitetet për mos-arritje të nivelit të shërbimit

Nëse kompania fituese nuk arrin të kryejë shërbimin sipas kohëve të përcaktuara më sipër do të mbahet 10% e pagesës nga fatura mujore e mirëmbajtjes.

8. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Të gjitha të drejtat mbi kodin burim dhe çdo dokumentacion teknik (mënyrën e konfigurimit të aplikacionit skica, etj.) do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor. Zgjidhja do të dorëzohet e shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar, për sistemin në tërësi, së bashku me setin e dokumentacionit teknik. Kodi burim duhet të dorëzohet i plotë dhe i përditësuar sa herë që mund të bëhen përditësime gjatë fazës së mirëmbajtjes, në fund të shërbimit të mirëmbajtjes.

-Fund-